



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 15.3.2024, e cila filloi në orën 14:00.

Në mbledhje morën pjesë: Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Tiera Kasumi-Berisha (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Arbër Limani (LVV), Faton Zeka (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Amir Simnica (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Besë Pestreshi (LDK) Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB), Endrit Zabërgja (NISMA).

**Munguan:** Berat Lahu (LVV), Driton Rukiqi (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Fehmi Kupina (i pavarur), Taulant Maxharraj (AAK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Endrit Gashi (AAK) dhe Valbona Ajeti (AAK).

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkryetar, Jehona Lushaku-Sadriu, nënkryetare, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Vigan Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donjeta Dragusha, drejtore e Drejtorisë së Zhvillimit Rural, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Emergjencave, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Donjeta Çetta, drejtore e Drejtorisë së Parqeve dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Ajet Brajshori**, anëtari më i moshuar i Kuvendit. Ai tha se para se të kalojmë në pikën e rendit të ditës, Besë Pestreshi, anëtare e re e Kuvendit, duhet ta bëjë betimin para Kuvendit.

Faqe 1 nga 5

**Besë Pestreshi**, anëtare e re e Kuvendit nga subjekti politik LDK, e bëri betimin para Kuvendit.

**Kryesuesi** tha se për këtë mbledhje është paraparë ky

### **Rend i ditës:**

- 1. Propozim-vendimi lidhur me miratimin e Raportit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera pas vërshimeve të mëdha që kanë ndodhur në komunën e Prishtinës gjatë vitit 2023.**

**Kryesuesi** hapi diskutimin.

**Donjeta Dragusha**, drejtore, tha se në bazë të Ligjit për vetëqeverisjes lokale dhe Ligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, të Rregullores për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, si dhe të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kryetari i Kryeqytetit ka marrë vendimin për themelimin e Komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në mars të vitit 2023. Komisioni është formuar prej 5 anëtarëve, 2 nga Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë, 1 nga Drejtoria e Inspeksionit, 1 nga Drejtoria e Zhvillimit Rural dhe 1 anëtar nga Drejtoria e Investimeve Kapitale. Komisioni pas pranimit të 155 kërkesave për vlerësimin e dëmeve, ka filluar punën në terren për shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre, ku si rrjedhojë komisioni ka përgatitur raportin për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera pas vërshimeve të ndodhura në Komunën e Prishtinës për vitin 2023. Votimi i këtij propozim-vendimi është më se i rëndësishëm për bujqit, pasi që tani është koha e mbjelljeve pranverore dhe aktiviteteve të tyre.

**Përparim Rama**, kryetar, lidhur me këtë propozimvendim tha se është më se e domosdoshme që të votohet ky propozim-vendim dhe për të kaluar tek niveli qendror për pagesa për bujqit, dhe kërkoi nga të gjithë që njëzëri të votohet ky propozimvendim.

**Gëzim Sveçla** tha se, para se të diskutojmë për pikën e rendit të ditës, është e domosdoshme me shprehur pakënaqësinë time dhe të Grupit që e përfaqësojë, lidhur me zhvillimet e djeshme në Kuvendin komunal. Ajo çfarë ka ndodhur dje këtu, nuk ka ndodhur në asnjë Komunë të Kosovës, në asnjë pushtet. Pamundësimi i punës së Kuvendit, ku në sallë ishin të pranishëm 30 asamblistë, apo gati 2/3 e numrit të përgjithshëm të asamblistëve, ndalja e mikrofonave, ndërprerja e transmetimit të drejtpërdrejtë, urdhërimi i stafit civil për sabotim, konsiderojmë se është dhunë.

**Triera Kasumi – Berisha** tha se ne duhet të dimë në raport se kur janë bërë njoftimet dhe a janë brenda afateve ligjore, ndërsa sa i përket përcaktimit të zonave të prekura nga fatkeqësitë, ka pasur mungesë të qartësisë dhe saktësisë në përcaktimin e kufijëve të zonave, si dhe në përdorimin e të dhënave territoriale për këtë qëllim, duke sjellë rreziqe

për vlerësimin e pasaktë të dëmeve dhe për ndërhyrje të pavendosura. Në raportimin për dëmet e vlerësuara nuk është zbatuar me saktësi detyrimi për paraqitjen e të dhënave të plota dhe dokumentacionin e nevojshëm për përcaktimin e dëmeve, duke e ulur transparencën dhe besueshmërinë e procesit të raportimit. Këto mangësi në përmbushjen e dispozitave të rregullores kanë sjellë dyshime në profesionalizmin dhe përgjegjësinë e institucioneve përgjegjëse në menaxhimin e dëmeve nga fatkeqësitë, në këtë rast komisionit. Bazuar në pikat e lartcekura, ne si Grup i asamblistëve konsiderojmë se komisioni, gjegjësisht kryetari i Komunës i ka tejkaluar të gjitha afatet ligjore për sjelljen e raportit në asamblenë komunale për miratim nga Kuvendi i Komunës dhe se kjo qasje dëmton më së shumti bujkun, për të cilin është themeluar ky komision.

**Milazim Vitija** kërkoi nga drejtorja e Drejtorisë së Zhvillimit Rural, që të përkrahen bujqit, blegtortë, bletarët e zonave rurale, sepse ata kanë shumë probleme, kështu që subvencionimi i qumështit është shumë me rëndësi të përkrahet.

**Leutrim Retkoceri** tha se është e pamundur që të kalohet në një pikë të thirrur për seancë të jashtëzakonshme e të mos ndërlihdet rasti pa precedent me seancën e djeshme të jashtëzakonshme. Situata në të cilën po kalon Kuvendi i Kryeqytetit dhe kaloi dje, në pengim të punës, me ndaljen e mikrofonave nga persona të lartë politikë të administratës, është akt i shëmtuar dhe zhgënjyes. Asamblistët e PDK-së si dje ashtu edhe sot, po tregojnë gatishmëri për mundësimin e kthimit të funksionalitetit të Komunës dhe të Kuvendit, andaj qasja penguese edhe sabotuese nuk duhet të na shërbejë asnjëherë. Ky raport duhet të ishte më i detajuar, sepse çdo vonesë në këtë raport i vonon bujqit. Vota e PDK-së është për t'i kompensuar dëmet e bujqëve, për t'i kompensuar dëmet e ekonomive familjare, bizneseve. Këtu kemi shtyrje të vlerësimit për gadi një vit, bujqit kanë nevojë për mbështetje.

**Gëzim Mehmeti** tha se nuk ka ndodhur asnjëherë të urdhërohet, që përfaqësuesve të zgjedhur të organit më të lartë nga qytetarët e Prishtinës, t'u mohohet e drejta elementare e fjalimit dhe ushtrimit të detyrës për të cilën jemi të zgjedhur, kështu që çështjen e ndodhisë së djeshme në Kuvend, siç po dëshirojnë disa, në mbledhjen e ardhshme do ta kemi në rend dite.

Sa i përket këtij raporti, të gjitha komunat tjera i kanë mbaruar raportet në dhjetor, tani Komuna e Prishtinës në mars e diskuton çështjen me shumë mangësi, me joprofesionalizëm, prandaj duhet edhe njëherë të verifikohet çështja e raportit që ka mangësi të mëdha, pastaj t'u ndihmojmë bujqve.

**Feim Osmani** tha se ky raport është dashtë të diskutohet vitin e kaluar, pasi që sot konsideroj se nuk kemi asnjë material të nevojshëm që ta vlerësojmë punën e këtij komisioni në bazë të raportit i cili na është dërguar. Duke parë situatën shumë serioze, duke ditur se nëse është arsyetimi që jemi vonë, ne jemi jashtë çdo afati kohor dhe tani të thërrasim një seancë tjetër, ose kështu të jashtëzakonshme apo të rregullt, dhe të pajisemi

më parë me dokumentacionin e nevojshëm, ta trajtojmë në mënyrë më meritorë këtë raport. Po ashtu, në listë janë edhe disa banorë që nuk i përkasin territorit të komunës së Prishtinës, janë në zonën kadastrale të komunës së Podujevës.

**Nora Kelmendi** tha se sa i përket situatës së krijuar dje në sallën e Kuvendit, ju bëj me dije se Komuna e Prishtinës nuk është kompani private, ku ju jeni aksionar apo drejtor menaxhues, Komuna është e qytetarëve të Prishtinës, kështu që kujdes nënkryetare se si silleni, ndalimi i fjalës së lirë dhe dhuna në Kuvend komunal ju bëjnë vetëm dëm gjatë gjithë jetës. Ju lutem, të tregoheni të pjekur profesionalisht në punën të cilën e bëni, sepse i bëni keq vetëm vetëvetes e jo neve.

Lidhur me raportin e prezantuar, kërkoj të dije se çfarë përgatitje profesionale kanë zyrtarët e përcaktuar si anëtarë të komisionit, se a ekziston dokumentacioni përcjellës me të cilën ne sigurohemi që komisioni ka pasur mjete të mjaftueshme për kryerjen e punëve profesionale, si dhe a është bërë dokumentimi me fotografi i dëmeve të shkaktuara, ashtu siç kërkohet. Po ashtu, komisioni si e ka bërë vlerësimin e dëmeve, si janë siguruar çmimet për vlerësimin e këtyre dëmeve, a janë siguruar këto çmime nga ATK -ja, gjithmonë bazuar në legjislacionin në fuqi, si dhe a është bërë shqyrtimi i raportit të komisionit nga kryetari i Komunës.

**Muhamet Selmani** u shpreh se ky raport është shumë i mangët, mungon lista e personave që janë refuzuar, nuk janë të definuara pikat e ankesave ose vërejtjet për të cilat janë refuzuar si bujiq. Kërkoj nga komisioni, në rast se ka mundësi që ky raport të plotësohet në qoftë se kemi vërejtje nga Ministria e Bujqësisë. Do të ishte mirë që të rishikohej edhe një herë ky dokumentacion, për të parë se çka mundë të bëjmë që t'ju ndihmojmë dhe të mos i refuzojmë nga kërkesa e subvencionimit, se këto dëme janë të bëra që një vit dhe ata nuk kanë marrë asnjë subvencion apo dëmshpërblim për këtë çështje.

**Gëzim Sveçla** kërkoj të dije se cila është përgatitja profesionale e anëtarëve të komisionit dhe a është ekuivalente me kriteret e parapara sipas rregullores. Po ashtu, cilat janë kriteret për përcaktimin e vlerës së atyre çmimeve dhe a janë këto çmime ekuivalente me çmimin e Agjencionit të Statistikave të Kosovës në periudhën në fjalë.

Dihet se nga niveli qendror mjetet materiale iu kanë shpërndarë komunave dhe komunat i kanë shpërndarë tek ekonomitë familjare, vetëm qytetarët e Komunës së Prishtinës të cilët kanë pësuar nga vërshimet, nuk janë rimbursua dhe faji mendoj se është i kryetarit të Kryeqytetit, Përparim Rama, dhe i komisionit të tij.

**Fiknete Bejta** tha se për vlerësimin e dëmeve në natyrë prej fatkeqësive natyrore që ndodhin brenda tri ditëve, merret çmimi për bazë, çmimi i atyre tri ditëve që kanë qenë për ato kultura bujqësore, dhe nëse ne ia dëshirojmë të mirën Kryeqytetit dhe bujqve, atëherë kishin votuar, sepse në këtë kohë jemi në kohën në sezonin e mbjelljeve dhe bujqit me gjithë atë sendimentë të ultë që kanë arritur vitin e kaluar, ia japim një shtysë që të kultivojnë kulturat e tyre bujqësore këtë vit.

**Hafiz Krasniqi** tha se pjesa e cila është e përshkruar në raport edhe përgjegjësitë që i ka marrë drejtorja dhe komisioni, jam i sigurt që diku janë të bazuara në ligj dhe në rregullore përkatëse dhe në asnjë mënyrë nuk ka këtu të bëjë me subjektivizëm. Kisha dëshiruar që edhe ata bujq që janë refuzuar nga ky komision për mospërbushje të dokumenteve, ka raste ndoshta për një certifikatë të lindjes, t'i japim një afat drejtorisë edhe komisionit, që në një takim tjetër kjo çështje të diskutohet edhe t'u japim edhe atyre bujqve një mundësi reale nëse vetëm është në pyetje për një dokument ose për një çështje shumë të vogël.

Lidhur me vërejtjet, pyetjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Donjata Dragusha, drjtore, Përparim Rama, kryetar dhe Xhevdet Ibrahimaj, përfaqësues i komisionit.

*Duke pasur për bazë diskutimet, vërejtjet dhe sugjerimet e parashtruara lidhur me Raportin për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera pas vërshimeve të mëdha që kanë ndodhur në komunën e Prishtinës në vitin 2023, Përparim Rama, kryetar, propozoi që ky raport të tërhiqet, të shqyrtohet edhe një herë në njërën nga mbledhjet e radhës së Kuvendit, duke i dhënë një mundësi komisionit edhe drejtorisë që të merren me pyetjet, vërejtjet dhe çështjet tjera të ngritura nga anëtarët e Kuvendit.*

*Mbledhja përfundoi në orën 16:30.*

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

Kryesues i mbledhjes së Kuvendit  
Ajet Brajshori



Faqe5nga5